

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kontejneri misterioz udhëtoi 62 ditë nga Brazili drejt Durrësit, detaje nga rrugëtimi i "mallit" të AMG Food
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/kontejneri-misterioz-udhetoi-62-dite-nga-brazili-drejt-durresit-detaj-i104252
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:38:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3bb8ba4028016a97785358ee739dc2638f263b8c5e2c51940c2dbdc75445812c
TEKSTI	c5dc2c60da8302a4c1747325cf44c7fe8ad8d0022fb29bbefc13a30516be5bda
PAMJA	9894b87f988798a84db2b73e8c7ae342e2ff953522a76b85e670b6d8d0080193

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e4113f20831257ea0804f6424e483df935515d4327dde899715ac5ca04665c5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e4113f20831257ea0804f6424e483df935515d4327dde899715ac5ca04665c5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **me lehtësira fiskale**

Demokratike kërkon nga qeveria që të luftojë

benet aktori me filmat më

karrierën e tij, duke u ngjitur në krye të listës

ekstradimin e Ervin Matës

Shqipërisë për ekstradimin e Ervin

me baktere për turistët AKU

qendrimin në ambientet

shpërblen trajnerin Luis de

nenshkrimin të kontrarës së re me

AKTUALITET

Kontejneri misterioz udhëtoi 62 ditë nga Brazili drejt Durrësit, detaje nga rrugëtimi i "mallit" të AMG Food

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 17:37



Kontejneri frigoriferik i AMG Food në pronësi të Mondit Goxhajt ka bërë një rrugëtim prej 62 ditësh nga Brazili drejt Portit të Durrësit. Hetuesit kanë nisur verifikimin e rrethanave të mbushjes së kontejnerit me 37 pako kokainë, e fshehur mes mishit të pulës që importohet nga Brazili.

Sipas Policisë së Durrësit, kokaina e kapur, në rast se do të shitej në treg, do të kapte një vlerë rreth 2 milionë euro. Dokumentacioni i ngarkesës e paraqiste atë si një kontejner me mish pulë të ngrirë. Hetimet po përqendrohen dhe në sqarimin se ku u furnizua kontejneri me kokainë, në Brazil apo në ndalesat tranzitore dhe kush ishte personi ose grupi që do ta merrte ngarkesën në Shqipëri. Hetimi duhet të përcaktojë gjithashtu, nëse droga është futur në kontejner pa dijeninë e importuesit apo nëse pas ngarkesës fshihet një skemë më e organizuar.

Rrugëtimi i kontejnerit

Rrugëtimi nisi në Itajaí, ku kontejneri doli bosh nga depoja e Maersk, Seara Hub Itajaí, më 14 korrik 2026. Më 29 korrik, ai hyri në terminalin JBS Terminais Itajaí, ndërsa më 5 gusht u ngarkua në anijen MAERSK LOTA / 632N. Anija u nis nga Itajaí më 5 gusht në orën 15:20, duke nisur kështu pjesën kryesore të udhëtimit ndërkontinental. Pas afro 20 ditësh lundrim, MAERSK LOTA mbërriti në Port Tanger Med, Marok, më 24 gusht në orën 20:58. Në Tanger Med, kontejneri u shkarkua dhe qëndroi në port për rreth 8 ditë, përpara se të ngarkohej në anijen LUNA MAERSK / 633E më 1 shtator. Kjo anije u nis më 2 shtator në orën 04:48, me destinacion Mesdheun Lindor.

Më 7 shtator, kontejneri mbërriti në Pire, Greqi, ku u shkarkua nga LUNA MAERSK. Pas rreth një dite e gjysmë, më 8 shtator, u ngarkua në anijen ushqyese (feeder) K OCEAN / 637N, e cila u nis nga Pireu më 9 shtator në orën 00:13. Destinacioni final ishte Durrësi. Feeder-i K OCEAN mbërriti në portin e Durrësit më 12 shtator në orën 17:43. Kontejneri u shkarkua më 13 shtator në orën 11:49, ndërsa më 13 shtator në orën 23:00 doli nga terminali. Më 14 shtator, në orën 12:35, u regjistrua hyrja përfundimtare në terminalin e Durrësit.

Nga nisja e anijes së parë nga Itajaí, më 5 gusht në 15:20, deri në mbërritjen e KOCEAN në Durrësi më 12 shtator në 17:43, kanë kaluar rreth 38 ditë e 2 orë nga nisja e parë detare deri në mbërritjen në portin shqiptar. Por kontejneri nuk ka qenë vazhdimisht në det. Gjatë rrugës ka pasur qëndrime dhe operacione në portet e Tanger Med dhe Pireut, ku është shkarkuar dhe ringarkuar në anije të tjera. Në total, nga dalja nga depoja në Itajaí më 14 korrik deri në hyrjen në terminalin e Durrësit më 14 shtator, udhëtimi i këtij kontejneri zgjati rreth 62 ditë.

Emri i AMG Food ishte bërë i njohur më herët për një tjetër çështje të rëndë.

Më 11 mars 2025, kompania importoi nga Brazili një ngarkesë me mish pulë. Sipas të dhënave të publikuara nga autoritetet dhe mediave, në analizat laboratorike u konstatua prania e bakterit Salmonella Typhimurium. Sasia e referuar zyrtarisht në atë periudhë ishte rreth 7.9-8 tonë, ndërsa burime mediatike raportuan se ngarkesa totale e filetos së pulës mund të arrijte deri në 18.3 tonë. Mishi kishte mbërritur në Portin e Durrësit më 11 mars. AKU kishte marrë mostra për analiza dhe laboratorit i ISUV nxori përgjigjen më 21 mars, duke konstatuar salmonelën. Sipas kompanisë AMG Food, produkti ishte shitur te 154 klientë, ndërsa u siguruan faturat e shitjeve për të mundësuar gjurmimin dhe tërheqjen e tij.

AKU raportoi se rreth 4.5 tonë ishin tërhequr nga tregu, ndërsa pjesa tjetër po kërkohet në pika të ndryshme të vendit.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 15 Shtator 17:19

[Aksident në aksin rrugor Lezhë-Shkodër, përplasen 3 automjete! 3 persona të plagosur](#)

Aksident me tre automjete, në afërsi të kryqëzimit të Gocajve, përçatë superstradës Lezhë-Shkodër. Përpl...

AKTUALITET 15 Shtator16:58

[**Aksidenti i rëndë në Dibër, plagosen 5 persona, 4 prej tyre nisen drejt Tiranës**](#)

Një aksident rrugor është regjistruar në aksin nacional Maqellarë–Peshkopi, ku kanë mbetur të plagosur 5 persona. Të...

AKTUALITET 15 Shtator16:30

[**Zjarr në një fshat në Gjirokastrë, rrezikohen banesat**](#)

Në hyrje të fshatit Andon Poçi ka rënë një zjarr i përmasave të mëdha, i cili për shkak të përhapj...

AKTUALITET 15 Shtator16:23

[**“O gazetar do të ekzekutojmë”/ Osman Stafa zbardh prapaskenat e kërcënimit: Autori është i identifikueshëm**](#)

Gazetari Osman Stafa ka zbardhur prapaskenat e kërcënimit të rëndë me vdekje që ka marrë së fundmi, duke denoncuar p&eu...

AKTUALITET 15 Shtator16:08

[**Kush fshihet pas kokainës në Durrës?! Dyshime se u trafikua nga grupi i Gerd Gjinararit në Belgjikë**](#)

Në Shqipëri, 37 pakot e kokainës së gjetura të hënën, në kontejnerin që transportonte mish pule nga Brazili, kanë...

AKTUALITET 15 Shtator15:57

[**Shtrenjtimi i naftës, PD: Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale**](#)

Pas shtrenjtimit të naftës në tregun me shumicë dhe pakicë, Partia Demokratike kërkon nga qeveria që të lehtësoj&...

AKTUALITET 15 Shtator15:45

[**Gjykata e Brazilit miraton ekstradimin e Ervin Matës**](#)

Gjykata Supreme Federale e Brazilit ka miratuar unanimisht kërkesën e Shqipërisë për ekstradimin e Ervin Matës. Vendimi ës...

AKTUALITET 15 Shtator15:19

[**Premium Beach Hotel në Golem servir djath me baktere për turistët, AKU zbarkon në hotel pas helmimit: Ja çfarë u konstatua...**](#)

Një grup turistësh raportohet se janë helmuar gjatë qëndrimit në ambientet e 'Premium Beach Hotel' në Golem. Ngjarja ka nd...

AKTUALITET 15 Shtator15:08

[**Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë**](#)

Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, mjeku dhe ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë. ...

AKTUALITET 15 Shtator14:35

[**Tentuan të vidhnin një motor, policia zë “mat” dy hajdutët dhe i vë në pranga**](#)

Dy shtetas grekë janë arrestuar nga policia në Athinë, pasi u kapën në flagrancë teksa dyshohet se po tentonin të vidh...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[**FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...**](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[**EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...**](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 14 Shtator

[**“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...**](#)


Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV






Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.